Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 946/26
Data 06.11.26

Prishtinë, 23.10.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3431_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në,

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.10, Nenit 30 dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës **27.02.2026** për licencim (vazhdim licecence) të aktivitetit të **furnizimit** me energji elektrike, të bërë nga ndërmarrja **EDS International KS L.L.C. (Emri i Biznesit dhe numri unik identifikues 810854457), adresa: Pejton, Mujo Ulqinaku, Nr. 5, Ap.10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.**

në seancën e mbajtur me datë 23.10.2026 nxori këtë:

V E N D I M

I. **I VAZHDOHET LICENCA** për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes **EDS International KS L.L.C.** me numër Licence **ZRRE/Li_77/21**, për periudhën kohore prej **23.10.2026** deri me **22.10.2031,** me mundësi vazhdimi nëse i licencuari aplikon jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës.

II. **Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **EDS International KS L.L.C.** të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

III. **OBLIGOHET EDS International KS L.L.C.** të përmbush kushtet e licencës të specifikuara në licencën **ZRRE/Li_77/21.**

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë **27.02.2026** ka pranuar nga ndërmarrja **EDS International KS L.L.C.** aplikacionin me dëshmitë përkatëse për vazhdim Licence të aktivitetit të **Furnizimit** me energji elektrike në Kosovë.

- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **EDS International KS L.L.C.** me datë **8 maj 2026** ka njoftuar përmes gazetës/portaleve palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për licencim nga ZRRE.

- Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.

- Vlen të theksohet se me 1 shtator 2026 i kishte skatuar afati për operim të licencuarit **EDS International KS L.L.C.** pasi që në mungesë të kuorumit të Bordit të ZRRE-së nuk ishte e mundur të merrej vendim lidhur me vazhdimin e licencës. Si rrjedhojë nga 1 shtator 2026 deri me 23 tetor 2026 është ndërprerë furnizimi i konsumatorëve të EDS International KS L.L.C. me energji elektrike. Kjo situatë është krijuar për shkak të mungesës së kuorumit të Bordit të ZRRE-së, pasi që tre (3) anëtarëve të Bordit të ZRRE-së u kishte skaduar mandati me datë 2 gusht 2026.

- Pas emërimit të anëtarëve të rinjë të Bordit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (me 5 tetor 2026), lënda e **EDS International KS L.L.C.** është shqyrtuar nga Bordi 23.10.2026, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

- Licenca e lëshuar sipas këtij Vendimi do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I. të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive të tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes **EDS International KS L.L.C.** dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Driton Gojani, Kryesues

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Vendimi i dërgohet:
- EDS International KS L.L.C.
- Arkivit të ZRRE-së